



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 199, datë 29.12.2020

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 58, DATË 30.06.2015
“MBI MASAT E VIGJILENCËS SË DUHUR DHE TË ZGJERUAR NGA SUBJEKTET E
LIGJIT MBI PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË
TERRORIZMIT”, E NDRYSHUAR.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 58, datë 30.06.2015 “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, e ndryshuar, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohen departamentet përkatëse, për zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE

Në Rregulloren nr. 58, datë 30.06.2015 “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, e ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 3,

- Në paragrafin e parë, pas fjalës “janë”, shtohet togfjalëshi “*subjektet që mbikëqyren nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare sipas legjislacioneve të fushës, si më poshtë:*”
- Në pikën e fundit, hiqet togfjalëshi “*fizik ose*”

2. Në Udhëzuesin “Për matjen e rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit”, në kapitullin III, me titull “Faktorët e Rrezikut”, në paragrafin 1, me titull Faktori “Rreziku gjeografik”, pas pikës 5, shtohen pikat 6 dhe 7 me këtë përmbajtje:

“6. Përdorimi i exchange-it për Mjete Virtuale ose shërbime të tranfertave të parave dhe vlerave që ndodhet në një juridiksion i cili ka mungesë ose parregullësi të legjislacionit të PPP/FT, përfshirë proceset KYC.

7. Dërgimi i fondeve në OSHMV të cilat operojnë në juridiksione që nuk kanë rregullore të Mjeteve Virtuale, ose nuk kane impelentuar masat e PPP/FT etj.”

3. Në paragrafin 2, me titull Faktori “Rreziku i klientit / entitetit” në germën “f”, në fund të fjalisë hiqet fjala “etj.” dhe pas kësaj germe shtohet germa “g” me këtë përmbajtje: “g) Depozitim të një shume të lartë me para në dorë në bankë nga një shtetas jo rezident me burim të deklaruar të ardhurash nga investimi jashtë vendit në monedha virtuale etj.”

4. Në paragrafin 3, me titull Rreziku i produkteve dhe shërbimeve/kategoritë e transaksioneve dhe marrëdhënieve të biznesit:

- pas germës “a”, hiqet lidhësa “dhe”;
- pas germës “b”, shtohet germa “c”, me këtë përmbajtje: “c) ofrimi i shërbimeve të Mjeteve Virtuale, si:
 - Depozitim cash të shumave nga individë klient të bankës dhe transferimi jashtë vendit në platformë exchange me objekt veprimtarie “shërbime në fushën e monedhave virtuale”;
 - Përfitimi i transfertave në vlera të vogla por periodike në llogari bankare të klientëve individë të dërguara nga platforma/kompani që kanë objekt veprimtarie “shitblerjen e kripto monedhave kryesisht Bitcoin” me burim fillestar të ardhurash të panjohur;
 - Depozitim me para në dorë dhe transferta jashtë vendit për pagesa për blerje mjesh teknologjike/pajisje që mund të shërbejnë edhe për gjenerim/kontroll të monedhave/mjeteve virtuale;
 - Transfertë në dalje nga klient të bankës në vlera të vogla për blerje monedhe bitcoin;
 - Importimi nga persona juridik i pajisjeve elektronike/mjeteve/makinerive që mund të shërbejnë për gjenerim/kontroll të monedhave/mjeteve virtuale.”
- shtohet pika 5 me këtë përmbajtje: “5. *Ofrimi i shërbimeve të Mjeteve Virtuale*”

5. Në Aneksin I, me titull “UDHËZIME SPECIFIKE PËR TREGUN E SIGURIMEVE DHE LETRAVE ME VLERË”, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Ky aneks, u drejtohet subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë në tregun e sigurimeve të jetës dhe risigurimit sipas Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe subjekteve të Ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020 “Për Tregjet e Kapitalit”.

6. Në Aneksin III, shtohet pika B me titull “TIPOLOGJI TË FINANCIMIT TË TERRORIZMIT DHE ARMËVE TË SHKATËRRIMIT NË MASË”, me përmbajtje si më poshtë:


“B. TIPOLOGJI TË FINANCIMIT TË TERRORIZMIT DHE ARMËVE TË SHKATËRRIMIT NË MASË

Në funksion të rritjes së kapacitetit parandalues dhe rritjes së efektivitetit kundër financimit të terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë subjektet duhet të jenë vazhdimisht të azhurnuar me ndryshimet e ligjit 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, si dhe me çdo material të përgatitur nga Autoriteti Përgjegjës apo Autoriteti Mbikëqyrës si dhe me publikimet e FATF.

Më poshtë paraqesim 2 Tipologji të Financimi Terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë, (sugjeruar nga DPPPP) të cilat duhet të shërbejnë si orientim/shembull nga subjektet e ligjit për PPP/FT nën mbikëqyrje të Autoritetit, megjithëse edhe vetë subjektet duhet të mbajnë parasysh, në baze të eksperiencave dhe përvojës të hartojnë vetë tipologji në procedurat e tyre të brendshme të cilat mund të jenë kërcenim për subjektin në këtë aspekt.

Tipologji nr. 1: Pagesa nëpërmjet një institucioni financiar.


Në këtë rast një institucioni financiar, i është kërkuar të kryejë një pagesë, për një kompani të regjistruar në një adresë false, në një shtet me një vënd që është subjekt sanksionesh ndërkombëtare.



Tipologji nr. 2: Kompani fasadë të përfshirë në kamuflimin e transfertave ndërkombëtare.

Një komisioner për shitjen e titujve, me shtetësi të dyfishtë të një vendi të BE dhe Iranit, përdor një kompani fasadë, të regjistruar në Ishujt Britanik (British Virgin Islands) e cila disponon llogari të shumta bankare.

Kompania përdoret për të fshehur gjurmët e transfertave dhe transaksioneve që kryhen në vende të ndryshme, në mënyrë që të shmangë vëmendjen e institucioneve financiare dhe autoriteteve kompetente në fushën e parandalimit të financimit të armëve të shkatërrimit në masë.



7. Në Rregulloren nr. 58, datë 30.06.2015 “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, e ndryshuar., shtohet Aneks VII si më poshtë:

“ANEKS VII

UDHËZIME SPECIFIKE PËR MJETET VITRTUALE DHE OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË MJETEVE VIRTUALE

Ky aneks, i drejtohet çdo Personi Juridik, i cili merret me ofrimin e shërbimeve të mjeteve virtuale, sipas Ligjit nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”.

Mjetet virtuale dhe shërbimet e lidhura me to, kanë potencial për të nxitur zhvillimin dhe efikasitetin financiar, por cilësitë e tyre të veçanta mund të krijojnë hapësira për pastrim paraje, financim terrorizmi apo akte të tjera kriminale. Mjetet virtuale janë të aksesueshme vetëm në formë elektronike. Ruajtja dhe transferimi i tyre mund të kryhen nëpërmjet software-ve, aplikacioneve telefonike apo kompjuterike.

Mundësia për të transferuar mjetet virtuale jashtë kufijve shumë shpejt, jo vetëm që i lejon kriminelët të zotërojnë, lëvizin, apo ruajnë asete jashtë sistemit financiar të rregulluar, por edhe e bëjnë më të vështirë për institucionet përgjegjëse identifikimin e origjinës së burimit të fondeve dhe aktivitetit kriminal në kohën e duhur.

Në këtë kuadër subjektet duhet të jenë të vëmendshëm ndaj tipologjive dhe metodologjive se si pastruesit e parave apo financuesit e terrorizmit mund të keqpërdorin mjetet virtuale dhe ofruesit e shërbimeve të mjeteve virtuale për ofruesit e shërbimeve financiare dhe subjekte të tjera të ligjit 9917/2008, i ndryshuar.

Spektori i mjeteve virtuale apo ofruesve të shërbimeve të mjeteve virtuale ka karakteristika specifike që mund të lehtësojnë pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit., si më poshtë:

1. Anonimiteti: Është një nga arsyet pse monedhat virtuale mund të keqpërdoren për pastrim parash apo financimi terrorizmi. Krijon vështirësi në monitorimin e tyre dhe identifikimin e palëve të përfshira në të.

Shembuj:

- a) Transaksion nga një klient, i cili përfshin më shumë se sa një lloj mjeti virtual pavarësisht kostove shtesë të veprimit, dhe veçanarisht ato mjete virtuale që ofrojnë shkallë më të lartë anonimiteti, si p.sh. kriptomonedhat me anonimitet të lartë (KAL) apo monedhat private.
- b) Lëvizja e mjeteve virtuale që operojnë në një treg publik, transparent si p.sh. ai i Bitcoin, në një exchange më të centralizuar dhe më pas tregëtim i menjëhershëm për KAL ose monedhat private.
- c) Klientët që operojnë si Ofrues të Shërbimeve të Mjeteve Virtuale (OSHMV) të parregjistruar apo licensuar në faqe rrjeti shkëmbimesh peer-to-peer (P2P).
- d) Aktivitet jo normal veprimesh i Mjeteve Virtuale (në volum dhe shpeshtësi) të shkëmbyera për cash nga portofol i platformave P2P, i cili nuk ka një shpjegim logjik biznesi.
- e) Mjete Virtuale të transferuara nga/ose drejt portofolëve që tregojnë histori aktiviteti të të përdorimit të OSHMV-ve, të cilat operojnë duke ndërthurur shërbimet e aseteve virtuale dhe platformat P2P.
- f) Fonde të depozituara ose të tërhequra nga adresa mjeteve Virtuale ose portofol të cilët kanë ekspozim direkt dhe indirekt drejt burimeve të dyshimta, përfshirë tregun e darknet, faqe të basteve apo aktiviteteve të paligjshme.
- g) Përdorues që aksesojnë platformën e OSHMV-ve duke përdorur emrat të Internet Domain përmes proxies ose duke përdorur Domain Name Registrars (DSN) që fshehin zotëruesit e vertetë të domain-it.
- h) Përdorues që përdorin platformat e OSHMV-ve përmes nje adres IP-je të lidhur me darknet ose një software të ngjashëm që ruan anonimitetin gjatë komunikimit, përfshirë email-e

dhe VPN. Transaksionet përmes partnerëve që në vend të OSHMV-ve, përdorin mjete komunikimi të koduara (p.sh. forume, lojëra online, aplikacione telefonike, etj.).

- i) Një numër i madh portofolësh, në dukje pa lidhje me njëri tjetrin, të kontrolluar nga e njëjta adresë IP (ose adresë MAC), e cila mund të përfshijë përdorimin e portofolëve mburojë të rregjistruar në përdorues të ndryshëm, për fshehur lidhjen e tyre me njëri-tjetrin.
- j) Përdorimi i Mjeteve Virtuale, dizanji i të cilave nuk është i dokumentuar saktësisht, ose që janë të lidhura me mjete të tjera që mund të përdoren për krijimin e skemave të mashtrimit, si skemat Ponzi.
- k) Marrja ose dërgesa e fondeve drejt OSHMV-ve, në të cilat procesi Njihe Klientin Tënd (KYC) është jo ekzistent ose i dobët.
- l) Përdorimi i ATM-ve të Mjeteve Virtuale pavarësisht komisioneve të larta të veprimeve apo/ose në zona me risk të lartë kriminaliteti. Përdorimi i ATM-ve në vetëvete nuk është i mjaftueshëm për të sinjalizuar një veprim të dyshimtë, por kur kombinohet me vendodhjen e makinerisë në një zonë të rrezikshme apo përdoret për veprime të vogla të përsëritura, atëherë duhet t'i kushtohet kujdes.

2. Burimi i të ardhurave: Për shkak të mënyrës së veprimit me mjete virtuale krijohet vështirësi në identifikimin e burimit të ardhurave dhe origjinës së fondeve të investuara në këto tregje.

Shembuj:

- a) Transaksionet me adresa Mjetesh Virtuale ose karta bankare, të cilat janë të lidhura me skema mashtrimi, zhvatje, adresa të sanksionuara, tregun darknet apo website të tjera të paligjshme.
- b) Transaksione Mjetesh Virtuale që kanë orgjinën ose destinacionshërbimet online të basteve.
- c) Përdorimi i një ose më shumë kartave të kreditit ose debitit, të cilat janë të lidhura me një portofol Mjetesh Virtuale, për të tërhequr shuma të mëdha parash të printuara, ose fondet që përdoren për blerjen e AV-ve burojnë nga depozitimet cash drejt kartave të kreditit.
- d) Depozitime drejt një llogarie ose adrese Mjetesh Virtuale në vlera shumë më të larta se zakonisht, ku burimi i fondeve është i panjohur, veprim që pasohet nga konvertimi në para të printuar, situatë që mund të jete tregues i vjedhjes së fondeve.
- e) Mungesa e transparencës ose informacioni i pamjaftueshëm mbi orgjinën dhe pronësinë e fondit, si në rastet e fondeve që përdorin kompanitë guackë ose Initial Coin Offering (ICO), ku të dhënat personale të investitorëve nuk janë të disponueshme, ose transaksioneve hyrëse nga sistemet online të pagesave përmes kartave të parapaguara, shoqëruar me tërheqje fondi të menjëherëshme.
- f) Një pjesë e madhe e pasurisë së klientit e ka burimin nga investimet në Mjete Virtuale, ICO të paligjshme etj.

3. Risku Gjeografik: Mundësitë e operimit kudo në botë ndihmojnë pastruesit e parave dhe financuesit e terrorizmit pasi ato mund të jenë vendosur në vende të cilat nuk kanë kontrolle efektive në kuadër të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

Shembuj:

- a) Fondet e klientit e kanë origjinën ose janë transferuar drejt një exchange, i cili nuk është i rregjistruar nën të njëjtin juridiksion si klienti.
- b) Klienti përdor një exchange Mjeti Virtual ose shërbime të tranfertave të parave dhe vlerave që ndodhet në një juridiksion i cili ka mungesë ose parregullësi të legjislacionit të PPP/FT, përfshirë proceset KYC.

Klienti dërgon fondet në OSHMV të cilat operojnë në juridiksione që nuk kanë rregullore të Mjeteve Virtuale, ose nuk kanë impelentuar masat e PPP/FT.

4. Operimi i Mjeteve Virtuale vetëm në internet ka rritur mundësin e përdorimit të krimeve kibernetike për pastrimin e parave. P.sh. Një nga mënyrat është vjedhja fondeve nga lojërat elektronike online dhe më pas konvertimi i tyre në monedha virtuale.

5. Transaksionet e Mjeteve Virtuale: Ekzistojnë një sërë faktorësh që lidhen me profilin dhe sjelljet jo të zakonit të dërguesit ose marrësit të Mjeteve Virtuale për arritjen e qëllimit të paligjshëm, PP/FT, si më poshtë:

A. Vlera dhe shpeshtësia e veprimit/transaksionit

- a) Strukturimi i transaksioneve në vlera të vogla ose shuma pranë kufirit të detyrimit për raportim apo rregjistrim, njësoj si strukturimi i verprimeve cash.
- b) Kryerja e disa transaksioneve në shuma të mëdha:
 - në hapësira të shkurtra kohore, si psh. brenda 24 orëve.
 - në mënyrë të rregullt dhe të strukturuar, pas të cilit nuk kryhet më asnjë transaksion për një periudhë të gjatë kohe, rast tipik i shantazheve përmes software-ve që bllokojnë aksesin në sistem derisa të kryhet pagesa e kërkuar.
 - në një llogari që ka qenë jo aktive për një kohë të gjatë ose në një llogari të sapo krijuar.
- c) Transferimi i menjëhershëm i Mjeteve Virtuale drejt disa Ofruesve të Shërbimeve të Mjeteve Virtuale (OSHMV), veçanërisht drejt OSHMV-e të rregjistruara apo që operojnë nën një juridiksion tjetër, i cili:
 - nuk ka lidhje me adresën ku klienti jeton apo ushtron biznesin; ose
 - kuadri ligjor dhe rregullativ i PPP/LFT është i dobët ose mungon.
- d) Depozitimi i Mjeteve Virtuale në një exchange në mënyrë të menjëhershme:
 - tërheqja e Mjeteve Virtuale pa ndonjë aktivitet tjetër shkëmbimi drejt Mjeteve Virtuale të tjera, një veprim i panevojshëm që gjeneron komisione veprimi.
 - konvertimi i Mjeteve Virtuale në lloje të ndryshme Mjetesh Virtuale, që po prapë gjenerojnë vetëm komisione veprimi, pa ndonjë shpjegim logjikë biznesi (si psh. diversifikim portofoli).
 - tërheqja e Mjeteve Virtuale nga një OSHMV dhe transferimi i menjëhershëm drejt një portofoli privat. Ky veprim e bën exchange-in apo OSHMV-në automatikisht objekt të pastrimit të parave.
- e) Pranimi i fondeve të dyshuara si të vjedhur apo rezultat i një mashtrimi

- depozitimi i fondeve nga adresa të Mjeteve Virtuale që janë identifikuar si mbajtëse të fondeve të vjedhura.

B. Tregues të dyshimtë të lidhur me rrjedhën e transaksionit

Transaksione të lidhura me përdoruesit e rinj

- a) Kryerja e një depozite fillestare me vlera të lartë për të hapur një marrëdhënie me një OSHMV, kur kjo shumë nuk përkon me profilin e klientit.
- b) Kryerja e një depozite fillestare me vlera të lartë për të hapur një marrëdhënie me një OSHMV dhe klienti fillon të tregëtojë të gjithë ose pjesën më të madhe të shumës së depozituar po atë ditë ose ditën pasardhëse, ose klienti tërheq të gjithë shumën të nesërmen. Duke qenë se pjesa më e madhe e Mjeteve Virtuale kanë limit për shumat e depozituara, pastrimi i parave në shuma të mëdha mund të bëhet përmes tregëtimitve over-the-counter (jashtë tregut të exchange ose përmes një brokeri).
- c) Një përdorues i ri tenton të tregëtojë të gjithë balancën e Mjeteve Virtuale, ose tërheq të gjithë Mjeteve Virtuale dhe tenton ti dergojë jashtë platoformës.

Transaksione të lidhura me të gjithë përdoruesit

- a) Transaksione që përfshijnë përdorimin e disa Mjeteve Virtuale, ose llogarive të ndryshme, pa ndonjë shpjegim logjik biznesi.
- b) Kryerja e transfertave të shpeshta në një periudhë të caktuar (si psh. në një ditë, javë, muaj etj.) tek e njëjta llogari e Mjeteve Virtuale:
 - nga më shumë se një person;
 - nga e njëjta adresë IP nga një ose më shumë persona;
 - në shuma të mëdha
- c) Transferta hyrëse nga portofol të ndryshëm pa ndonjë lidhje me njeri-tjetrin, në shuma relativisht të vogla të pasuara nga një transfertë drejt një portofoli tjetër ose shkëmbim për para. Transaksione të tilla që kryerja e shkëmbimit të AV në para me rezultat potencial humbjeje (psh. kur vlera e AV është e luhatshme ose pavarësisht komisioneve shumë të larta në krahasim me standartet e industrisë, dhe veçanërisht kur transaksioni nuk ka shpjegim logjik).
- d) Konvertimi i shumave të mëdha të parave në AV, ose i shumave të mëdha të AV-ve në AV të tjera, pa shpjegim logjik biznesi.

C. Parregullsi të konstatuara gjatë krijimit të llogarisë

- Krijimi i llogarive të ndryshme nën emra të ndryshëm për të anashkaluar kufizimet në veprime ose limite të tërheqjes të vendosura nga OSMHV-të.
- Veprime të nisura nga adresa jo të besuara IP-sh, adresa IP-sh nga vende me juridiksion të sanksionuar, ose adresa IP-sh të etiketuara më parë si të dyshimta.
- Tentativa të vazhduara për të hapur një llogari në OSHMV nga e njëjta adresë IP-je.

D. Parregullsi të konstatuara gjatë vigjilencës (KYC)

- Informacion i pamjaftueshëm (KYC), ose një klient refuzon kërkesën për dokumenta apo deklarin e burimeve të fondit gjatë procesit të vigjilencës.
- Dërguesi nuk është në dijeni ose nuk ka informacion të plotë rreth transaksionit që po kryen, burimit të fondeve apo marrëdhënies me marrësin.
- Klienti ka falsifikuar dokumenta ose ka edit-uar foto apo të dhëna të tjera të mjeteve të identifikimit.

E. Profili i klientit

- Një klient paraqet detaje të llogarisë (p.sh. një adresë IP-je jo standarte, flash cookies), të ndara me një llogari tjetër.
- Adresa e IP-së e deklaruar në profilin e klientit është e ndryshme nga adresa e IP-së nga e cila është kryer transaksioni.
- Adresa e AV-së një klienti shfaqet në forume publike që njihen për aktivitete të paligjshme.
- Nga informacione publike, klienti mësohet se është ose ka qenë i përfshirë në aktivitete kriminale.

F. Profili i një klienti mashtrues ose viktimë e mashtrimit

- Klienti shfaqet jo komod me teknologjinë e AV-ve apo përdorimin e portofolëve virtual. Persona të tillë mund të jenë të rekrutuar nga pastrues parash profesionistë, apo viktima të mashtrimit të cilët nuk janë në dijeni të plotë të veprimit që po bëjnë.
- Një klient në moshë shumë më të madhe sesa mesatarja e përdoruesve të platformës hap një llogari dhe kryen një numër të lartë transaksionesh, duke hedhur dyshime se mund të jenë duke u përdorur nga të tjerë për pastrim parash ose viktima të mashtrimit financiar të personave të moshuar.
- Një klient i cili është financiarisht vulnerabël dhe përdoret nga shpërdarësit e drogës për ti asistuar në veprimet e tyre kriminale.
- Klienti ble shuma të mëdha të Mjeteve Virtuale, veprim që bie ndesh me pasurinë apo profilin e tij historik financiar, situatë që mund të jetë tregues i pastrimit të parave, shfrytëzimit të individit apo viktimë e mashtrimit.

G. Veprime të tjera jo të zakonta

- Një klient i cili ndryshon shpesh informacionet e tij personale, përfshirë adresën e-mail-it, adresën e IP-së, apo informacion financiar, që mund të jetë.
- Klienti përpiqet vazhdimisht të aksesojë një ose më shumë OSHMV, përmes adresave të ndryshme IP-ish brenda një dite.
- Përdorimi i gjuhëve të kodifikuara në fushat e mesazhit të Mjeteve Virtuale, që mund të jenë tregues i transaksioneve të kryera në funksion të aktiviteteve të paligjshme apo blerjen e drogërave.
- Një klient kryen në mënyrë të vazhdueshme transaksione me një numër të caktuar individësh etj.”